



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2754/5 prot.

Datë 14.02.2024

V E N D I M
Nr. 180/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.94/2024, datë 26.01.2024, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group Sh.A, OSSH Sh.A, FSHU Sh.A, FTL Sh.A për një vit” me fond limit 59,032,679.90 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 29.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, me NIPT K21605003M dhe adresë: autostrada Tiranë - Durrës, rruga dytësore, km 9, god 3- katëshe, Tiranë.
- Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë.
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, me NIPT L91418502J, dhe adresë: Durrës, Zona Kadastrale Nr. 8517, e llojit truall plus ndërtesë 4 kate, me sipërfaqe trualli 1000 m² dhe sipërfaqe ndërtesë 330 m², Durrës, Spitalë.

Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q, dhe adresë: autostrada Tiranë - Durrës, Km 8, Kodër Kashar, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 26.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.94/2024, ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga ankimuesi “Interlogistic” SHPK për operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group Sh.A, OSSH Sh.A, FSHU Sh.A, FTL Sh.A, për një vit”, me fond limit 59,032,679.90 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 29.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.*
2. *Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga ankimuesi “Interlogistic” SHPK për operatorin ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për procedurën e sipërcituar të prokurimit.*
3. *Autoriteti Kontraktor të skualifikojë operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, sipas vendimmarjes së tij dërguar në KPP me shkresën nr. 6413/16 prot., datë 23.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2750/3 prot., datë 30.11.2023.*
4. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.*
5. *Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga ankimuesi “Infosoft Office” SHPK, për operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, për procedurën e sipërcituar të prokurimit.*
6. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.*
7. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Interlogistic” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK.*

8. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*

9. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.890/ 1 prot., datë 08.02.2024, protokolluar me tonën nr. 2570/17 prot., datë 12.02.2024, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 94/2024 datë 26.01.2024 duke i bashkëngjitur shkresës edhe Urdhërin nr. 6413/17 prot. datë 02.02.2024 “Për heqjen nga pezullimi të procedurës me objekt “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group Sh.A, OSSH Sh.A, FSHU Sh.A, FTL Sh.A për një vit” si dhe procesverbalin e KVO nr. 6 datë 07.02.2024 “Për rivlerësimin e procedurës mb kufirin e lartë monetar “E hapur-mallra” (me mjetet elektronike) me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group sh.a, FSHU Sh.A, FTL Sh.A për një vit”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.890/ 1 prot., datë 08.02.2024, protokolluar me tonën nr. 2570/17 prot., datë 12.02.2024, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 94/2024 datë 26.01.2024 duke i bashkëngjitur shkresës edhe Urdhërin nr. 6413/17 prot. datë 02.02.2024 “Për heqjen nga pezullimi të procedurës me objekt “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group Sh.A, OSSH Sh.A, FSHU Sh.A, FTL Sh.A për një vit” si dhe procesverbalin e KVO nr. 6 datë 07.02.2024 “Për rivlerësimin e procedurës mb kufirin e lartë monetar “E hapur-mallra” (me mjetet elektronike) me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group sh.a, FSHU Sh.A, FTL Sh.A për një vit”.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik dhe ka skualifikuar operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK sipas vendimmarjes së tij dërguar në KPP me shkresën nr. 6413/16 prot., datë 23.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2750/3 prot., datë 30.11.2023 dhe operatorin ekonomik “Infosoft Office” SHPK në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.94/2024 datë 26.01.2024.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor, e ka zbatuar vendimin Nr.94/2024 datë 26.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group Sh.A, OSSH Sh.A, FSHU Sh.A, FTL Sh.A për një vit” si dhe procesverbalin e KVO nr. 6 datë 07.02.2024 “Për rivlerësimin e procedurës mb kufirin e lartë monetar “E hapur-mallra” (me mjetet elektronike) me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group sh.a, FSHU Sh.A, FTL Sh.A për një vit”.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group Sh.A, OSSH Sh.A, FSHU Sh.A, FTL Sh.A për një vit” si dhe procesverbalin e KVO nr. 6 datë 07.02.2024 “Për rivlerësimin e procedurës mb kufirin e lartë monetar “E hapur-mallra” (me mjetet elektronike) me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group sh.a, FSHU Sh.A, FTL Sh.A për një vit”.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

